

## Marrëveshje për Pagesën e Borxhit

Kjo Marrëveshje për Pagesën e Borxhit (në tekstin e mëtejme: marrëveshja), është lidhur ndërmjet palëve:

- **VAPIK - Visual Authors, Producers, and Interpreters of Kosovo**, me seli në rr. Luan Haradinaj, 10 000 Prishtina, Kosoval; (tutje referuar si: VAPIK)

dhe

- **IPKO Telecommunications L.L.C.**, me seli në Rr. Zija Shemsiu, nr. 34, Prishtinë, Kosovë, me numër unik identifikues 810485301, përfaqësuar nga Drejtor Menaxhues, Andrés Páli; (tutje referuar si: Operatori)

VAPIK dhe Operatori mund të referohen individualisht si "palë" ose kolektivisht si "palët".

Duke qenë se VAPIK, në bazë të Mandatit që buron nga leja nr. 002-11712020 lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 07.11.2012, me Vendimin Nr.13/38 të datës 30.10.2020, të gjithë operatorët kabllorë që ritransmetojnë materiale vizuale me të drejtë autori, duhet të respektojnë dhe paguajnë tarifën e të drejtës së autorit tek VAPIK.

Duke qenë se palët kanë nënshkruar MARRËVESHJE PËR PAGESËN E TARIFAVE MUJORE PËR SHFRYTËZIMIN E LËNDËS SË MBROJTUR ME RASTIN E RITRANSMETIMIT e datës 15 korrik 2024 (tutje referuar si marrëveshja bazë).

Prandaj, tani, Palët bien dakord të paguajnë borxhin sipas kushteve të mëposhtme:

### Neni 1

1. Operatori kabllor pranon të paguaj borxhin e akumuluar sipas pikës I të marrëveshjes bazë.

### Neni 2

1. Palët pajtohen që, për vlerën totale të detyrimeve të akumuluar, VAPIK, do të lëshoj faturën për IPKO-në, bazuar në raportin të cilin ky i fundit, vë në dispozicion të VAPIK, gjegjësisht, nga 1 prill 2021 deri më 31 korrik 2024.
2. Palët pajtohen që, IPKO, pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, të vë në dispozicion te VAPIK, raportin nga sa më sipër.
3. Palët pajtohen që, borxhi i akumuluar të paguhet sipas ratave si në aneksin 1 - plani i pagesave.

### Neni 3

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të mbetet në fuqi deri në momentin që parashikohet pagesa totale e ratave si në aneksin 1 - plani i pagesave.

Neni 4

1. Palët pajtohen se kompetencë për zgjidhjen e kontesteve që burojnë nga kjo Marrëveshje është Gjykata kompetente ne Prishtinës.

Neni 5

1. Në zbatim të marrëveshjes bazë, përshtatshëmrisht dispozitës I. të së njejtës, palët pajtohen që, kjo marrëveshje dhe i gjithë dokumentacioni përcjellës është subjekt publikimi nga ana e VAPIK, me qëllim sigurimin e transparencës së këtij të fundit, sa i përket ekzekutimit të pagesave nga ana e operatorëve si dhe sa i përket raportimit të borxheve eventuale të akumuluarra pranë Ministrisë kompetente. Megjithatë, të dhënat konfidenciale, siç janë, numri i përdoruesve nuk do të shpërndalet nga ana e VAPIK.
2. Në zbatim të marrëveshjes bazë, përshtatshëmrisht, të gjitha dispozitat që rregullojnë marrëveshjen për pagesën e borxhit, siç janë vonesat potenciale në pagesë dhe të ngjajshme, do të aplikohen në mënyrë të përcaktuar, për qëllim të zbatimit të kësaj Marrëveshje.

Pas leximit dhe analizimit të tekstit të Marrëveshjes, Palët e nënshkruajnë pa vërejtje.

Data: 31.07.2024

**IPKO Telecommunications L.L.C.**

**András Páli, Drejtor Ekzekutiv**

*András Páli*

**VAPIK - Visual Authors, Producers, and**

**Interpreters of Kosovo**

*J. J. J. J.*



*Handwritten mark*

*Handwritten mark*